

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA



Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 01.02.2016 jep këtë:

Mendim juridik

Në kuptim të nenit 292 të LPP, kur veprimi i caktuar në këtë procedurë duhet të kryhet nga dikush tjetër e jo nga debitori, debitori mund të urdhërohet, me kërkesën e kreditorit që debitori të depozitojë në gjykatë shumën e caktuar të nevojshme për pagimin e shpenzimeve që do të shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër, apo nga vet kreditori. Në situatën faktike kur debitori nuk e depoziton shumën e mjeteve financiare të propozuar nga kreditori, në pajtim me nenin 13 pika 1 të LPP, në të cilin thuhet se shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht i paguan kreditori, mund të urdhërohet kreditori që të depozitojë në gjykatë shumën e caktuar të nevojshme për pagimin e shpenzimeve që do të shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër.


A r s y t i m

Gjykata Themelore në Prizren, ka kërkuar dhënien e mendimit juridik, se i duhet vepruar kur debitori në lëndët përmbarimore, në kuptim të nenit 292 të LPP, është urdhëruar që të depozitojë në gjykatë shumën e caktuar të nevojshme për pagimin e shpenzimeve që të do shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër, apo nga vet kreditori dhe ai nuk bënë depozitimimin e kësaj shume të mjeteve financiare.

Lidhur me këtë çështje, dega civile e kësaj Gjykate mendon se dispozita e nenit 292 të LPP, ka të bëjë me detyrimin e veprimit që mund të kryhet nga çdokush, e jo nga debitori, andaj, kur veprimi i caktuar në këtë procedurë duhet të kryhet nga dikush tjetër e jo nga debitori, debitori mund të urdhërohet, me kërkesën e kreditorit që debitori të depozitojë në gjykatë shumën e caktuar të nevojshme për pagimin e shpenzimeve që do të shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër, apo nga vet kreditori. Në situatën e tillë kur debitori nuk e depoziton shumën e mjeteve financiare të propozuar nga kreditori, kjo dispozitë ligjore nuk jep përgjigje të caktuar se si duhet të veprohet më tutje. Mirëpo, neni 13 pika 1 të LPP (e cila është normë standarde që rregullon këtë çështje), jep përgjigje gjeneroze, në të cilin thuhet se” shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht i paguan kreditori”, ndërsa në kuptim të kësaj dispozite juridike, përkatësisht par.4, debitori detyrohet që kreditorit më vonë t’ia paguajë të gjitha shpenzimet procedurale dhe të gjitha shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës së përmbarimit.

Nga kjo që u tha, rezulton se në pajtim me këtë dispozitë juridike, procedura e përmbarimit duhet të vazhdojë ashtu që kreditori do të depozitojë në gjykatë shumën e caktuar të nevojshme për pagimin e shpenzimeve që do të shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër, në rast se debitori nuk depoziton mjetet financiare të lartpërmendura, e cila shumë më vonë kreditorit do t’i kompensohet nga ana e debitorit.

Prof. Dr. Fejzullah Hasani



Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës